



INTESA SANPAOLO BANK

Albania

Kodi i Etikes

Tabela e lendes

Vlerat tona	3
Pergjegjesia sociale dhe ambientale e Intesa Sanpaolo Bank Albania..	3
Misioni i kompanise.....	3
Parimet dhe vlerat e referimit.....	4
Parime te sjelljes ne marredhenie me te gjithë partneret e biznesit.....	5
Parime te sjelljes ne marredheniet me klientet.....	5
Parime te sjelljes ne marredheniet me aksioneret.....	7
Parime te sjelljes ne marredheniet me bashkepunetoret.....	9
Parime te sjelljes ne marredheniet me furnizuesit.....	9
Parime te sjelljes ndaj mjedisit.....	10
Parime te sjelljes ne marredheniet me komunitetin.....	11
Mekanizmat per zbatimin e parimeve, qeverisjen dhe kontrollin e brendshem.....	11
Zbatimi i Kodit te Etikes.....	11
Administrimi i Kodit te Etikes.....	12
Procedurat per administrimin e brendshem dhe kontrollin e Kodit te Etikes	12
Veprimet ne rastin e mosperputhshmerise rregullative.....	13
Raportimi i rasteve te mosperputhshmerise rregullative.....	13

Shenim i rendesishem: Ky Kod Etike eshte nje pershtatje lokale e Kodit Etik te Kompanise Meme, kod nga i cili frymezohet dhe me te cilin eshte ne perputhje ne vecanti lidhur strategjite afatgjate.

Vlerat Tona

Pergjegjesia sociale dhe ambientale e Intesa Sanpaolo Bank

Intesa Sanpaolo Bank Albania i bashkohet grupit Intesa Sanpaolo ne perpjekjet per te kontribuar ne ruajtjen e mjedisit natyral, shendetit, punes, se ardhmes, mireqenies se individit dhe shoqerise dhe mbrojtjen e sistemit te marredhenieve sociale.

Ne kete kuader Intesa Sanpaolo Bank Albania promovon dhe zbaton politika dhe praktika te pergjegjesise sociale lidhur me stafin e saj, klientet, furnizuesit dhe aksioneret.

Ky Kod, mjet i qeverisjes, eshte pjese e nje vizioni te gjere me pergjegjesi sociale dhe mjedisore, qe ve ne qender raportin tone me te gjithe palet e interesuara. Nga dialogu konstruktiv me ta, lind dhe zhvillohet nje proces qe gjeneron permiresim te vazhdueshem, nepermjet degjimit te kerkesave dhe inkuadrimit te tyre duke respektuar strategjine e kompanise.

Implementimi dhe monitorimin i zbatimit te ketyre politikave si dhe raportimin rigoroz, na ndihmojne qe ti mbajme gjalle vlerat e shprehura ne kete Kod dhe te sigurojme funksionimin e tyre ne jeten e kompanise sone.

Misioni i kompanise

Intesa Sanpaolo Bank Albania si pjese e Grupit Intesa Sanpaolo punon per t'i ofruar klienteve te saj sherbime bankare dhe financiare te shkelqyera, duke mbeshtetur zhvillimin e vendit si dhe te komuniteteve shqiptare, ne rajon e me gjere

Ne synojme nje zhvillim te qendrueshem dhe krijimin e nje procesi te bazuar ne besimin re rezulton plotesimi i kerkesave te klienteve dhe aksionereve tane, nje ndjesi perkatesie e punonjesve tane dhe nje monitorim te vazhdueshem te nevojave te komunitetit.

Konkurojme ndersherisht ne treg gati per te bashkepunuar me subjektet e tjere ekonomike private dhe publike, sa here qe eshte e nevojshme per te perforcuar kapacitetin e pergjithshem te rritjes se ekonomive te vendeve ku ne operojme.

Marrim persiper pergjegjesine e menaxhimit te kursimeve, impenjohemi per shtrirjen e aksesit ne kredi dhe mjetet financiare per te gjitha qytetet si dhe per zhvillimin e sistemit sipermarres, te ndergjegjshem qe vendimet tona kane efekte, direkte ose indirekte, mbi mjedisin natyror dhe komunitetin, per mireqenien (jo vetem ate materiale) e te cilit duam te japim kontributin tone nepermjet mbeshtetjes dhe realizimit te iniciativave kulturore ne dobi te komunitetit.

Parimet dhe vlerat e referimit

Strategjia jone, eshte pasqyrim i startegjise globale te Grupit Intesa Sanpaolo, qe synon krijimin e vlerave te qendrueshme nen profilin ekonomik dhe financiar , social dhe ambiental, te ndertuar mbi besimin e te gjitha partnereve tane te biznesit dhe bazuar tek vlerat vijuese:

Integritet

Permbushim objektivat tane me ndershmeri , korrektesi dhe pergjegjshmeri , duke respektuar rregullat, etiken profesionale dhe ne fryme te marreveshjeve te nenshkruara.

Persosmeri

I kemi vene vetes qellimin e permiresimit te vazhdueshem , duke pare larg, duke perafruar sfidat e se nesermes, duke kultivuar krijueshmerine e prirur drejt risive , duke vleresuar dhe shperblyer meritat.

Transparence

Veme transparencen ne baze te veprimeve tona, te komunikimit dhe kontratave tona per tu lejuar te gjitha partnereve tane te bejne zgjedhje te pavarura dhe te vetedijshme.

Respektim i specifikave

Duam te bashkerendojme dimensionin e Grupit me vecorite specifike te tregut lokal, te jemi nje banke qe mendon ne largpamesi dhe qe nuk humb nga vemendja individin.

Drejtesi

Impenjohemi te eliminojme cdo diskriminim tek sjellja jone , te respektojme diferencat e gjinise , moshes, races, perkatesise fetare, politike ose sindakale , gjuhes ose aftesive te ndryshme.

Vlera e individit

Vlera e personit udheheq menyren tone te te vepruarit :perdorim dialogun si leve permiresuese me marredheniet me partneret tane.

Pergjegjesi ne perdorimin e burimeve

Kemi per qellim te perdorim ne menyre te kujdesshme te gjitha burimet , duke promovuar sjelljet qe mundesojne evitimin e shpenzimeve , duke privilegjuar zgjedhjet te qendrueshme ne kohe.

Parime te sjelljes ne marredhenie me te gjithë partneret e biznesit

Intesa Sanpaolo Bank Albania ne linje me parimet e Grupit Intesa Sanpaolo dhe Global Compact te promovuar nga OKB tek e cila aderom:

- impenjohet ne mbeshtetjen e mbrojtjes se te drejtave njerezore sipas principeve te shpallura ne Deklaraten Universale te 1948
- njeh principet e percaktuara nga Konventat themeltare te ILO(Organizata Nderkombetare e Punes) dhe vecanerisht te drejten e asociimit dhe negociimit kolektiv , ndalimin e punes se minoreneve dhe mosdiskriminimin ne punesim.
- kontribuon ne luften kunder korrupsionit , duke ndjekur linjat guide te OECD (Organizata per Bashkepunim Ekonomik dhe Zhvillim) dhe principet anti-korrupsion te vendosura nga Kombet e Bashkuara ne 2003.

Parime te sjelljes ne marredheniet me klientet

Degjim dhe dialog

Besojme qe klienti duhet te jete gjithmone ne qender te vemendjes tone dhe qe vetem nje dialog konstant mund te lejoje kuptimin e rezultateve te pritshme dhe mbajtjen e marredhenieve tona ne nje nivel persosmerie:

- ne zhvillimin e sherbimeve dhe produkteve te reja perdorim mjete sistematike dialogu, duke pranuar sugjerimet e vete klienteve ,
- nepermjet dialogut me klientet tane , identifikojme me kujdes profilin e tyre te riskut, pike fillimi kjo shume e rendesishme per te ofruar konsulence dhe produkte financiare ne koherence me nevojat e tyre, me vetedijen e kryerjes se nje roli te rendesishem gjate asistences ne investime dhe menaxhimit te kujdesshem te kursimeve
- pergjigjemi menjehere pyetjeve dhe ankesave duke synuar nje zgjidhje reale dhe jo formale te problemeve qe lindin

Transparence

Besojme qe ne baze te nje raporti jetegjate dhe te bazuar ne besim, eshte komunikimi qe afteson klientin te kuptoje karakteristikat dhe vleren e te gjithë produkteve dhe sherbimeve qe blen ose qe i ofrohen:

- Thjeshtezojme produktet, lehtesojme kuptimin e kontratave, reduktojme keqkuptimet e mundshme duke ofruar nje informacion mese te qarte dhe te plote.
- Pergatisim nje komunikim te qarte ne te gjitha kanalet e disponueshme

Drejttesi(Paanesi)

Besojme qe tek produktet dhe sherbimet tona duhet te kete akses kushdo:

- Nuk diskriminojme klientet tane ne baze te kombesise, fese ose gjinise.
- Aplikojme nje politike cmimesh ne linje me cilesine e produktit dhe sherbimit te ofruar

Akses ne Kredi

Duke pasur ne konsiderate parimet e kujdesit ne vleresimin e merites kreditore, fale te cilave mbrojme jo vetem interesat tona por edhe ato te klientit:

- Percaktojme zonat e mundshme te nderhyrjes dhe zgjerojme, per pasoje, oferten tone me produkte dhe sherbime qe plotesojne kerkesat e dinamikave sociale gjithnje ne zhvillim.

- Mbeshtesim zhvillimin e siper marrjes se re per te favorizuar aktivitetet me potencial krijimi vlerash ekonomike dhe sociale akoma te pashprehura
- Ne perputhje me politikat e Grupit, perpiqemi te ndertojme instrumente qe lehtesojne aksesin ne kreditim per organizatat e orientura drejt qellimeve sociale si dhe organizatave jo-fitimprures te cilat contribuojne me aktivitetin e tyre ne permiresimin e klimes sociale ne vend.

Mbeshtetje ndaj zhvillimit te Vendit

Besojme qe nje banke e madhe ka pergjegjesi specifike ne promovimin e rritjes ekonomike dhe sociale te vendit ku vepron:

- Mbeshtesim siper marrjet ne zhvillim, ne permiresimin e konkurrences se tyre dhe ne zhvillimin e biznesit.
- Mbeshtesim siper marrjet, te pajisura me projekte te vlefshme, edhe ne momente te veshtira, duke i shoqeruar ne realizimin e zgjidhjeve inovative te rikonstruksionit dhe promovimit
- Mbeshtesim sektorin publik dhe entet lokale, sipas kriterëve te bashkepunimit dhe ndarjes se roleve , duke promovuar zgjidhje financiare qe garantojne nje ekuilibër te periudhes se gjate , nen nje vizion rritjeje dhe modernizimi qe te ndihmoje ne permiresimin e cilesise se jetes se qytetareve
- Ne aktivitetet per projektet infrastruktorore, aplikojme standartet me te mira dhe udhezimet te njohura nderkombetarisht per vleresimin e impakteve sociale dhe ambientale

Promovim i ekonomive lokale dhe mbeshtetja e komuniteteve shqiptare jashte Shqiperise

Besojme qe nje mbeshtetje efikase, mund te aktivizojte te gjitha potencialet e pashprehura te rrjetit siper marres te perbere nga nder marrje te vogla dhe te mesme:

- Konsiderojme themeltare vleren e marredhenieve me komunitetin dhe peraftrimin me nevojat tregut ku operojme. Per kete percaktojme mjete dhe procese te brendshme organizuese te drejtuara drejt thjeshtezimit dhe zhvillimit te nje oferte te volitshme, duke dashur te jemi banke marredheniesh dhe jo vetem rrjet shitjeje.
- Jemi afer komuniteteve nen optiken e zhvillimit te produkteve e sherbimeve qe lehtesojne integrimin e komuniteteve shqiptare dhe ne vendet jashte territorit shqiptar
- Promovojme iniciativa me vlere te larte sociale , edhe ne partneritet me opertaore qe kane kompetenca specifike ne keto fusha te nderhyrjes
- Zhvillojme multikanalizimin per te favorizuar aksesin tek sherbimet tona

Investime socialisht te pergjegjeshme

Besojme qe investimet duhet ti kushtojne gjithnje e me shume rendesi kriterëve sociale, mjedisore dhe qeverisjes se mire te nder marrjeve me qellim promovimin e nje zhvillimi te ekuilibruar. I ofrojme klienteve mundesine e zgjedhjes se produkteve te administruar sipas kriterëve etike dhe synojme aktivizimin e nje procesi me sensibilizimin progresiv te vete klienteve dhe impenjimit te nder marrjeve drejt sjelljeve te pranueshme.

Mbrojtja dhe siguria

Besojme qe mbrojtja dhe siguria e klienteve tane, e aktiveve dhe informacioneve konfidenciale te tyre, nuk perfaqesojne vetem nje detyre primare, por jane edhe ne baze te raportit te besimit qe ne duam te mbajme:

- Kujdesemi per mbrojtjen e personave, te vlerave dhe te mirave , informacionit dhe te proceseve te brendshme organizuese ne menyre qe te japim nje sherbim qe te permbushe ne maksimum kerkesat e besueshmerise, vazhdimesise dhe ruajtjes se sekretit
- Sigurojme veprimin ne perputhje me ligjin
- Respektojme kriteret e transparences absolute gjate informimit te klienteve mbi te drejten e tyre te privacise dhe modalitetet me te cilat trajtojme informacionet personale.

Vleresim i rrezikut social-ambiental

Besojme qe vendimet tona per te investuar dhe politika jone kreditore, duhet te kene parasysh edhe rreziqet sociale-ambientale sipas parimit qe nje aktivitet qe prodhon vlere ekonomike mund te jete i besueshem vetem nese nuk shkaterron njekohesisht vlera sociale ose ambientale:

- Aderojme tek protokollet kombetare dhe nderkombetare per respektimin e standarteve social-ambientale
- Promovojme bashkejetesen paqesore edhe duke evituar mbeshtetjen financiare ndaj aktiviteteve qe mund ta ekspozojne ndaj rrezikut

Parime te sjelljes ne marredheniet me aksioneret

Drejtesi

- Kujdesemi qe te gjitha aksionereve tu sigurohet nje ruajtje e vazhdueshme ne kohe e vlerave te kapitalit te investuar
- Sigurojme barazine e informacionit dhe kujdesin e permiresuar dhe konstant ndaj aksionereve , pa diskriminime dhe sjellje preferenciale

Transparenca drejt tregut

Te gjitha komunikimet financiare te Intesa Sanpaolo Bank Albania, si dhe ato te qe i jane paraqitur Autoriteteve Mbikqyrese dhe te Kontrollit, vendase te huaja, kane transparence dhe informacion te plote dhe te menjehershem , si dhe respektim te normave ne fuqi dhe kodeve te vetedisiplines te aprovuara:

- I garantojme aksionereve dhe komunitetit financiar nje komunikim transparent dhe te menjehershem me qellimin per te dhene nje informacion komplet mbi gjendjen e strategjive dhe rezultateve te bankes. Per te garantuar barazine e informacionit, kjo vihet ne dispozicion nepermjet disa kanalesh, perfshire faqen web ku ne vecanti publikohen:
 - Pasqyrat financiare
 - Raporti vjetor
 - Komunikatat per shtyp dhe prezantimi ne treg i rezultateve te korporates
 - Dokumentat kryesore te korporates

Politikat e shperblimit per drejtimin dhe punonjesit

Krahas parashikimeve te percaktuara ne Statut, ne legjislacion dhe rregulloret aktualisht ne fuqi, ne parashikojme zbatimin e iniciativave te shperblimit transparent dhe sistemeve stimuluese duke perfshire te gjitha nivelet dhe gradat e punonjesve tane, me qellim inkurajimin kompetitiv, terheqjen dhe ruajtjen e aftesive me te mira profesionale brenda Grupit. Gjate percaktimit te struktures se shperblimit dhe stimujve, garantojme nje rol qendror per Keshillin Drejtues te Bankes. Ne Mbledhjen e pergjithshme te Aksionereve, raportojme ne menyre te vazhdueshme ne lidhje me politikat e miratuara per shperblimin e punonjesve dhe iniciativat e stimulimit; duke parashikuar dhe shperblimin per Anetaret e Keshillit Drejtues;

Keshilli Drejtues eshte pergjegjes per miratimin e politikave te shperblimit te punonjesve.

Ne lidhje me kriteret qe aplikohen ne menyre te vazhdueshme, politika per shperblimin (duke perfshire edhe komponentet e ndryshueshem) qe eshte miratuar per stafin ka per baze drejtesine, meriten dhe qendrueshmerine e rezultateve. Udhezimet per percaktimin e politikave per shperblimin e drejtuesve bazohen ne parametrat dhe elementet objektive qe rezultojne nga vleresimi i detyrave si dhe performanca dhe potenciali, me qellim krijimin e nje sistemi te integruar per administrimin e punonjesve dhe ne funksion te zhvillimit te tyre.

Sistemet tona te shperblimit jane ne perputhje me politikat qe mbrojne administrimin e kujdesshem te rrezikut dhe me strategjite afat-gjata. Parashikojme nxitjen e formave te shperblimit - ne raport me rezultatet e kompanise - te cilat duhet te jene ne perputhje me rrezikun e marre persiper dhe e strukturuar ne menyre te tille per shmangjen e stimujve te cilat nuk perputhen me interesat e bankes ne kuadrin afat-gjate.

Te gjitha anetaret e Keshillit Drejtues shperblehen ne baze te te gjitha periudhes ne detyre dhe nuk bazohet ne instrumente financiare, apo stimuj te cilat lidhen me rezultatet ekonomike. Ne lidhje me shperblimin e Administratorit te Deleguar dhe drejtimin, parashikojme limite ne baze te nje balance te komponenteve te qendrueshem dhe te ndryshueshem, dhe ne lidhje me kete te fundit, aplikojme mekanizma te pershtatshme te vleresimit te rrezikut duke garantuar keshtu nje lidhje me rezultatet efektive dhe te qendrueshme.

I njejti sistem kufizimi i cili ka si synim balancimin e duhur midis komponenteve te qendrueshem dhe te ndryshueshem formon dhe perben bazen per politikat e hartuara per punonjesit, duke perfshire operatoret e tregut dhe tregtaret. Ne sigurojme gjithashtu shperblimin e nevojshem per personat pergjegjes per kontrollin e brendshem dhe per drejtuesit qe jane pergjegjes per hartimin e pasqyrave financiare, duke marre ne konsiderate pergjegjesite dhe angazhimin e tyre gjate kryerjes se detyres.

Aplikojme nje kufi per shperblimin e parashikuar ne rast nderprerje te marredhenies se punes, ne baze te rregullave ligjore dhe kontraktuale dhe rregulloreve qe jane aktualisht ne fuqi. Ne perjashtojme dhenien e stimujve ne rastin e rezultateve negative.

Parime te sjelljes ne marredheniet me bashkepunetoret

Respektimi i personave

Besojme qe respektimi i personalitetit dhe dinjitetit te cdo bashkepunetori eshte baza per zhvillimin e nje ambienti te punes te karakterizuar nga besimi reciprok, ndershmeria dhe i pasuruar nga rezervat e secilit:

- Perdorim mjete rekrutimi dhe menaxhimi te bashkepunetoreve te shenuara nga sjellje te drejta dhe koherente, duke parashikuar favorizime, abuzime dhe diskriminim te bazuar te gjinia, etnia, feja, perkatesia politike dhe sindakale, gjuha , mosha ose aftesi te tjera.
- Garantojme shanse te barabarta zhvillimi dhe rritjeje profesionale, aksesit ne proceset formuese dhe iniciativat e azhornimit dhe shperndarjes se roleve.
- I njohim te gjitha bashkepunetoreve mundesine e shprehjes se individualitetit dhe krijimtarise ne pune dhe vleresojme vecantite dhe specifikat e secilit , si shtytje ndaj risive dhe kontribut te madh per rritjen e Grupit.
- Kerkojme persosmerine e rezultateve nen profilin kuantitativ dhe kualitativ , nepermjet veprimeve komerciale dhe politikave te buxhetit te adresuara, planifikuara dhe te monitoruara ne koherence me principet etike te ketij Kodi dhe duke respektuar profesionizmin dhe dinjitetin e cdo bashkepunetori, si dhe duke studiuar karakteristikat e territorit ku operon.
- Tregojme kujdesin me te madh ne percaktimin e objektiveve duke favorizuar mirekuptimin me qellim promovimin e sjelljeve korrekte dhe transparente ne marredhenie me klientelen
- Ngrejme sisteme stimulimi objektiv dhe transparente, duke parashikuar objektiva te mundshem dhe te arritshem.
- Lehtesojme punen duke thjeshtezuar produktet, procedurat dhe format e komunikimit dhe garantojme shendetin dhe sigurine me masa gjithnje e me efikase.
- Promovojme politika qe te lehtesojne ekuilibrin mes jetes profesionale dhe personale, me vetedijen qe sfera private perfaqeson nje pjese themelore ne jeten e kujtdo.

Vleresim dhe motivim

Duam qe ne baze te vleresimeve,motivimeve dhe zhvillimit te karrieres te njerezve tane , te jete drejtesia dhe meritat:

- Pranojme qe kompleksiteti i marredhenieve intelektuale,organizuese dhe teknike te cdo bashkepunetori, eshte burimi yne kryesor strategjik , te cilin impenjohemi ta tutelojme dhe vleresojme si faktor celes te avantazheve konkurruese te vazhdueshme.

- Perdorim sisteme vleresimi te sjelljeve , te kompetencave, te dijeve dhe potencialeve sipas kriterëve te transparences dhe te vleresimit te meritave me qellim perforcimin e motivimit, te vleresimit me drejtesi dhe favorizimit te perndjekjes se rezultateve te ekselences (persosmerise).
- Zhvillojme nje formim te kujdesshem ndaj kerkesave personale, me bindjen qe degjimi i nevojave te shprehura nga bashkepunetoret, eshte shume i rendesishem per percaktimin e proceseve formuese.
- Secili eshte ne gjendje te interpretojme me se miri rolin e vet, duke favorizuar permiresimin konstant te nivelit te kompetences duke zhvilluar aftesine per te punuar ne skuader per arritjen e objektivave te korporates.
- Promovojme pjesemarrjen pergjegjese te personave dhe i kerkojme te impenjohen gjithnje ne menyre aktive.
- I kerkojme personave te bashkepunojne per perdorimin e pergjegjshem te te gjitha burimeve te perdorura per kryerjen e detyrave.

Degjim dhe dialog

Besojme qe dialogu dhe degjimi jane ne baze te marredhenieve te karakterizuara nga besimi:

- Promovojme rolin strategjik te komunikimit te brendshem per t'u lejuar individeve pjesemarrje ne jeten e korporates;
- Komunikimi shenohet nga kriteret e korrektesise, thjeshtesise dhe transparences;
- Zhvillojme mjete per perhapjen e informacionit dhe promovojme diskutimin e eksperiencave duke favorizuar keshtu krahasimet dhe integrimin midis subjekteve te ndryshme territoriale te Grupit;
- Impenjohemi per te zhvilluar, tek ato qe mbulojne detyra me pergjegjese , nje ndjeshmeri specifike ne kapjen e nevojave te bashkepunetoreve, si dhe vleresimin e sugjerimeve te tyre dhe opinionet e ndryshme, si mundesi permiresimi dhe rritjeje te korporates.

Kohezion

Kohezioni eshte elementi dallues e nje komuniteti personash qe punojne mire se bashku me krenarine e te qenit pjese e nje korporate te madhe.

Per te rritur dhe konsoliduar shpirtin e perkatesise se te gjithë bashkepunetoreve:

- Shpjegojme dhe shperndajme vlerat tona, duke verifikuar ne menyre te vazhdueshme aktualitetin, ne menyre qe secili te mund ta njohë veten brenda tij.
- Veme ne dispozicion te te gjithëve informacionet mbi strategjite dhe objektivat e bankes dhe te Grupit, me qellim ndarjen me te tjeret te elementeve qe karakterizojne identitetin tone.
- Rrisim , tek ato qe kane funksione me pergjegjese, aftesine per t'u propozuar si guide dhe pike referimi per kryerjen e aksioneve gjithnje e me koherente me principet etike te korporates.
- Ndjekim politika menaxhimi dhe stimuluese ne gjendje te njohin dhe vleresojne kontributin individual dhe te grupit per arritjen e objektivave.
- Parashikojme forma te bashkepjesemarrjes edhe ekonomike tek sukseset e korporates.
- Promovojme iniciativa te solidaritetit per te mbeshtetur koleget ne veshtiresi dhe per qellime sociale te rendesishme.

Parime te sjelljes ne marredhenie me furnizuesit

Degjim dhe dialog

Besojme qe nje sjellje e karakterizuar nga degjimi dhe perballimi me furnizuesit tane favorizon nje permiresim te vazhdueshem te marredhenies, e forcon ate nepermjet:

- Nje sjelljeje te bazuar tek besimi qe perfshin furnizuesit.
- Pershkrimin nga ana e furnizuesve te nivelit te tyre te kenaqesise, duke gjetur zonat me nevojë permiresimi, dhe ne vecanti persa i takon transparences, komunikimit dhe respektimit te termave te pagesave.

Transparenca

Besojme qe nje sjellje e qarte dhe transparente kontribuon ne mbajtjen e raporteve te mira me furnizuesit. Jemi te bindur qe integriteti duhet te perbeje nje kusht te pakthyeshem te marredhenies, prandaj:

- Zgjedhim furnizuesit tane ne baze te kritereve te qarta dhe te dokumentueshme, nepermjet nje procedure objektive dhe transparente.
- U perbahemi politikave te korporates , vecanerisht ne drejtimin dhe mbylljen e kontratave, duke evituar situata konflikti interesash, edhe potenciale.
- Ne rastin specifik te konsulencave profesionale, zgjedhjet tona frymezohen nga kritere profesionale dhe kompetente, duke evituar konflikte interesash, edhe potenciale.
- Komunikojme jashte politikat tona persa i perket marredhenieve me furnizuesit.

Drejtesi

Besojme qe nje banke e madhe duhet te dije te drejtoje ne menyre te pergjegjshme pozicionin qe ze:

- Garantojme shanse te barabarta ne seleksionimin e furnizuesve dhe partnereve komerciale, duke pasur parasysh perputhshmerine me nevojat dhe permasat e korporates tone.
- Perpiqemi qe kontratat e mbyllura me interlokutoret tane te jene te karakterizuar nga drejtesia, vecanerisht duke ju referuar afateve kohore te pagesave dhe permbushjes se detyrimeve administrative.

Parime te sjelljes ndaj mjedisit

Mbrojtja e ambientit eshte nje nga dimensionet kryesore te pergjegjshmerise tone. Bashkohemi me idene se nje Grup i madh bankar si Intesa Sanpaolo mund te ushtroje nje impakt domethenes persa i takon ambientit, ne vecanti ne kontekstin social dhe ambiental ku eshte prezent me aktivitetin e tij, ne periudha te gjata ose te shkurtra. Garantojme respektimin e plote te parashikimeve ligjore ne kuadrin e ambientit.

- Kerkojme vazhdimisht zgjidhje te reja dhe efikase ne fushen e mjedisit , edhe nepermjet ofertes se produkteve dhe sherbimeve specifike ndaj klienteles dhe zgjidhjesh per furnizuesit tane.
- Shperndajme praktika te mira persa i perket pergjegjesis se ambientale , edhe nepermjet zbatimit te principeve nderkombetare te nenshkruara, si psh Deklarata UNEP, Global Compact i Kombeve te Bashkuara, tek te cilet kemi aderuar.

Perdorim i pergjegjshem dhe efektiv i burimeve

- Ndjekim nje konsum te vetedijshem te burimeve te nevojshme per kryerjen e aktivitetit tone, edhe nepermjet implementimit te nje sistemi te drejtimit ambiental dhe permiresimit progresiv te energjise efektive te aktiviteve tona.
- Edhe nepermjet monitorimit te te dhenave ambientale dhe sensibilizimit te personave qe punojne ne banke synojme nje permiresim te vazhdueshem te sjelljes tone ndaj ambientit.

Pergjegjesi ambientale dhe sociale gjate rrjetit te furnizimit

- Pergjegjesia jone ndaj ambientit dhe shoqerive, shtrihet pergjate krejt rrjetit te furnizimit dhe prandaj preokupojme politikat e furnizuesve tane drejt tuteles se ambientit dhe respektimit te te drejtave njerezore dhe te punetoreve.
- Vleresojme pozitivisht furnizuesit qe karakterizohen gjate aktivitetit te tyre nga mbeshtetja ndaj ambientit duke perdorur mjetet e nevojshme per te minimizuar impaktet negative te shkaktuara nga aktiviteti i tyre.
- Sensibilizojme furnizuesit tane drejt nje sjelljeje te pergjegjshme , qe te favorizojte vetedijen e risqeve dhe mundesive ambientale, sociale dhe etike qe derivojne nga aktiviteti i tyre.

Parime te sjelljes ne marredhenie me komunitetin

Dialogu me shoqatat perfaqesuese te partnereve tane

Mendojme qe dialogu me shoqatat ka nje rendesi strategjike per zhvillimin e aktivitetit tone ne menyre te vazhdueshme:

- Degjojme dhe marrim parasysh mendimet e shprehura nga nyjet e ndryshme te shoqerise civile, rreth aktivitetit tone.
- Mbajme te hapur nje kanal komunikimi me shoqatat qe perfaqesojne interesat e stakeholder-ave tane, me objektivin per te bashkepunuar rreth respektimit te interesave reciproke dhe parashikimit te situatave te mundshme te konfliktit.

Mbeshtetje ndaj komuniteteve nepermjet kontributeve dhe sponsorizimeve

Njohim nevojat, jo vetem materiale, te komunitetit dhe i mbeshtesim edhe nepermjet dhenieve te lira dhe sponsorizimeve:

- Ne zgjedhjen e sektoreve te nderhyrjes u kushtojme vemendje te vecante koherences ndaj vlerave tona referuese, ne merite te iniciativave qe na propozohen dhe rendesise se nevojave sociale mes te cilave dhe tutela e pasurise historike, artistike dhe kulturore qe duam te realizojme.
- Veprojmë sipas modaliteteve transparente nepermjet procedurave qe evitojne cdo konflikt te mundshem interesash ne rang personal ose korporate.
- Bejme te mundur qe sponsorizimet te mos influencohen nga interesat komerciale.

Marredhenie institucionale

Marredheniet tona institucionale me Shtetin dhe Organizmat nderkombetare kane si qellim te vetem konstatimin e perfshirjes se aktivitetit legjislativ dhe administrativ ndaj Intesa Sanpaolo Bank Albania, t'u pergjigjen kerkesave informale ose sidoqofte te beje te ditur pozicionin mbi temat e rendesishme:

- Vendosim kanale komunikimi te dedikuara dhe te autorizuara me te gjithë interlokutoret institucionale ne nivel nderkombetar, te brendshem dhe lokale.
- Perfaqesojme interesat tona ne menyre transparente.
- Pershtasim modele specifike organizuese per parandalimin e krimeve ndaj Administrates Publike, ne mbrojtje te interesave te korporates dhe te te gjithë te interesuarve.
- Kontribuojme ne menyre aktive tek iniciativat e ndermarra nga shoqatat dhe organizmat qe synojne rritjen e stabilitetit dhe korrektesise se sistemit bankar dhe financiar.

Mekanizmat per zbatimin e parimeve, qeverisjes dhe kontrollit te brendshem

Mekanizmat per zbatimin, qeverisjen dhe kontrollin te cilat paraqiten ketu kane si qellim arritjen dhe permbushjen e objektiveve te meposhtme:

- Inegrimin e strategjive, politikave dhe procedurave te Bankes me parimet e etikes dhe vlerat;
- Auditimin dhe kontrollin e perputhshmerise se veprimeve dhe sjelljeve me standartet e etikes se bankes.

Zbatimi i Kodit te Etikes

Kodi i Etikes dhe amendimet e tij ne te ardhmen do te miratohen nga Keshilli Drejtues dhe Keshilli Mbikqyres i Intesa Sanpaolo.

Njesia e Pergjegjesise Sociale te Korporates, pjese e Zyres se Perputhshmerise Rregullative, eshte pergjegjese per perditesimin e Kodit.

Administrimi i Kodit te Etikes

Proçedurat per perhapjen, pjesemarrjen dhe perfshirjen

Kodi i Etikes publikohet ne faqen e internetit (www.intesasanpaolobank.al) ku mund te aksesohet nga klientet dhe palet e interesuara; gjithashtu eshte i disponueshem dhe ne nje seksion ne rrjetin e brendshem te Bankes.

Nje kopje e printuar e Kodit i dorezohet çdo drejtori, punonjesi ose bashkepunetori te jashtem ne momentin e vendosjes se marredhenieve, punesimit ose fillimit te marredhenies se bashkepunimit.

Vlerat dhe parimet qe Intesa Sanpaolo Bank Albania deshiron te afirmoje nepermjet Kodit te Etikes do te perhapen nepermjet trajnimeve te ndryshme te cilat kane si qellim arrijten e konsensusit per permbajtjen e Kodit te Etikes dhe sigurimin e mjeteve per rritjen e ndergjegjesimit dhe njohurive per mekanizmat dhe proçedurave per perdorimin e parimeve etike ne sjelljet e aktiviteteve te perditshme.

Ne menyre te veçante, trajnimet do te pergatiten ne perputhje me detyrat dhe pergjegjesite e secilit pjesemarrës dhe do te zhvillohen sipas nje proçesi i cili do te plotesoje trajnimin e tyre profesional dhe do te kontribuojne ne rritjen e tyre.

Kultura dhe vlerat e Kodit te Etikes do te zhvillohen dhe do te perhapen nepermjet te gjitha kanaleve te brendshem te komunikimit.

Vleresimi i ecurise se tyre sipas detyrave dhe pergjegjesive do te marre ne konsiderate edhe ne perputhshmerine dhe zbatimin e parimeve te Etikes qe rregullojne marredheniet midis punonjesve.

Proçedurat per administrimin e brendshem dhe kontrollin e Kodit te Etikes

Intesa Sanpaolo Bank Albania ka miratuar dhe zbaton Kodin e Sjelljes i cili eshte ne perputhje te plote me parimet etike dhe vlerat e Kodit aktual, ku parashikohen standartet baze dhe kryesore te sjelljes se drejtoresve, punonjesve dhe konsulentëve ne funksion te zbatimit dhe mbrojtjes se vlerave te Kodit te Etikes.

Modeli nga i cili eshte frymezuar Intesa Sanpaolo Bank Albania bazohet ne pergjegjesine individuale te departamenteve qe zbatojne dhe mbrojne vlerat e reputacionit te sjelljes sociale te pergjegjshme. Intesa Sanpaolo Bank Albania eshte angazhuar ne hartimin dhe zbatimin e politikave operative per çdo fushe te aktivitetit te cilat kane ndikim dhe impakt te madh etik dhe ne reputacionin e Bankes.

Çdo departament i Bankes ruan dhe garanton veprimet dhe aktivitetet e tyre ne perputhje me parimet dhe vlerat e Kodit te Etikes. Per kete arsye secili Departament eshte pergjegjes direkt, brenda fushes se tij te influences, per percaktimin dhe formalizimin e objektivave si dhe te planit ne vijim te veprimeve dhe projekteve per t'i dhene nje kuptim te prekshem Parimeve te Sjelljes te cilat diktojne sjelljen e Bankes ne te gjitha marredheniet qe ajo vendos, edhe ne aspektin e marredhenieve midis shume bashkepunetoreve dhe partnereve.

Nder te tjera secili departament eshte pergjegjes per realizimin e kontroleve sipas fushes se kompetencave qe zoterojne, duke identifikuar rastet e mosperputhshmerise rregullative te cilat mund te ndodhin ne departament dhe duke i raportuar ato prane departamenteve pergjegjese sipas proçedurave te vendosura nga kompania.

Drejtoret e Divizioneve/Zyrave, ne funksion te efikasitetit te parimit te vete-pergjegjesise, do te caktojne nje person pergjegjes per Pergjegjesine Sociale te Korporates (CSR). Ata do te operojne brenda departamentit ne fjale dhe ne rrjet midis departamenteve. Ata do te bashkepunojne gjithashtu edhe me Personin Pergjegjes per Pergjegjesine Sociale te Korporates ne Zyren e Perputhshmerise Rregullative me qellim identifikimin e objektivave te pergjegjesise sociale brenda departamentit te tyre, monitorimin dhe menaxhimin, si dhe raportimin periodik ne lidhje me projektet ne proçes dhe mirembajtjen e marredhenieve me bashkepunetoret.

Personi pergjegjes per Pergjegjesine Sociale te Korporates ne Zyren e Perputhshmerise Rregullative mbeshtet dhe keshillon departamentet e kompanise, mbikeqyr dhe analizon pergatitjen e procedurave te monitorimit per te garantuar perputhshmerine e politikave, produkteve, dhe proceseve me Kodin e Etikes. Ne funksion te kesaj, ne bashkepunim me departamentet e ngarkuara, midis tyre ne veçanti Departamenti i Ambjenteve, Prokurimeve dhe Sherbimeve te Pergjithshme ne Divizionin e Operacioneve dhe Departamenti i Burimeve Njerezore, identifikon treguesit e caktuar te cilet mundesojne vleresimin e arritjeve te objektivave sociale dhe ambjentale. Keto vleresime do te perfishihen ne nje raport per te garantuar respektimin e angazhimeve dhe detyrimeve. Gjithashtu, bashkepunon me Departamentin e Burimeve Njerezore per zhvillimin dhe perhapjen e kultures dhe vlerave qe permban Kodi i Etikes.

Kryen kontrole dytesore me qellim percaktimin e çeshtjeve te mundshme kritike, monitoron zhvillimin e tyre, dhe ne bashkepunim me departamentet e perfishira, merr masa korrigjuese per zgjidhjen e ketyre çeshtjeve kritike.

Propozon ndryshimet e nevojshme qe duhet te behen ne Kod ne menyre qe te jete ne linje me situaten aktuale te Bankes.

Garanton komunikim te vazhdueshem me Drejtorin e Pergjithshem Ekzekutiv te Bankes, Komitetin Ekzekutiv, edhe nepermjet Komitetit te Kontrollit, ne lidhje me menaxhimin dhe trajtimin e perditshem te situatave te papritura.

Departamenti i Kontrollit te Brendshem te Bankes mbikeqyr per te siguruar qe operacionet dhe proceset e Bankes kryhen siç duhet dhe per te garantuar perputhshmerine me rregullat e percaktura nga Kodi i brendshem i Sjelljes per te mbrojtur vlerat e aktiviteteve, duke perfishire angazhimet etike te bankes dhe pergjegjesite sociale (kontrolli etik).

Mbeshtet dhe asiston Komitetin e Kontrollit te Bankes gjate mbikqyrjes se perputhshmerise me parimet dhe vlerat qe permban Kodi i Etikes. Per kete qellim, merr dhe analizon raportet per shkeljet e Kodit te Etikes.

Komiteti i Kontrollit te Bankes, ne funksion te rolit mbikeqyres, mbikeqyr perputhshmerine dhe respektimin e parimeve dhe vlerave te Kodit te Etikes. Komitetit i dorezohet nje raport periodik qe publikon njesia per Pergjegjesine Sociale te Korporates ne Zyren e Perputhshmerise Rregullative, ne baze te informacionit qe ka siguruar Zyra e Perputhshmerise Rregullative dhe Kontrolli i Brendshem per rezultatet e kontroleve qe kane te bejne me proceset e brendshme te perputhshmerise rregullative qe kane kryer te gjitha strukturat e bankes, administrimin e masave korrigjuese, si dhe parregullsites serioze dhe rastet e mosperputhshmerise rregullative.

Veprimet ne rastin e mosperputhshmerise rregullative

Ne rastet e mosperputhshmerise rregullative te ketij Kodi, Intesa Sanpaolo Bank Albania do te marre masat e nevojshme sipas nje perqasje konstruktive – ne rastet e ndryshme nga sjellja mashtruese ose veprimet e kryera duke shkelur ligje te caktuara, kontrata ose rregullore – ndonjehere edhe duke krijuar programe trajnimi per te perforcuar ndjeshmerine dhe vemendjen e individeve lidhur me perputhshmerine me vlerat dhe parimet e deklaruar ne Kodin e Etikes.

Raportimi i rasteve te mosperputhshmerise rregullative

Raportet per rastet e mosperputhshmerise me Kodin aktual duhet te dergohen ne adresen e emali-it code.ethics@intesasanpaolobank.al ose me poste te zakonshme ne adresen: Intesa Sanpaolo Bank Albania, Zyra e Perputhshmerise Rregullative, Rr. Barrikadave, 1016, Tirane, Shqiperi.

Intesa Sanpaolo Bank Albania garanton se kushdo qe do te raportoje nje rast mosperputhshmerie ne mirebesim do te mbrohet nga çdo forme shpagimi, diskriminimi ose penalizimi dhe garanton konfidencialitetin maksimal, perveçse ne rastet kur parashikohet ndryshe nga ligji.